33086

REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E SHKALLES SE PARE TIRANE
Nr 33086

# V E N D I M
# PER RREGJISTRIMIN SI PERSON JURIDIK

Ne Tirane sot me daten 01 03.2005 une A. Coço gjyqtare e Gjykates se Shkalles se Pare Tirane, mbasi studiova kerkesen dhe dokumentat e kerkuesve Zef Gjetja per rregjistrimin e shoqerise "LEZHA-KONSTRUKSION"sh.p.k.si person juridik.

## K O N S T A T O V A:

Kerkuesit si me siper me kerkesen drejtuar Gjykates kerkon rregjistrimin ne Rregjistrin Tregtar te shoqerise "LEZHA-KONSTRUKSION"sh.p.k. si person juridik me objekt:

-Ne fushen e tregtimit me shumice e pakice, import eksport te artikujve te ndryshem ushqimore e Industriale. Prodhim e tregtim te materialeve te ndertimit, inerte, blloqe e soleta betoni,tregetim makinerish dhe automjetesh, pjese kembimi per makineri dhe automjete, pike shitje me pakice i karburanteve, gazit te lenget dhe i vajrave lubrifikante, Ndertime civile-Industriale-Turistike-Bujqesore deri ne 5 kate, Ndertim rruge-ura e vepra arti, Ndertim ujesjellesa-kanalizime-Kanale e impiante vaditje, Ndertim Sillosa, kulla, Kulla uji prej B/arme-metalie, punime karpentierie druri, pastrim i siperfaqeve urbane si dhe cdo lloj aktiviteti te lejuar me ligj.

Me seli ne Tresh, Lezhe, me administrator Ortakun Zef Gjetja me aktivitet privat mbi 10 vjet, Kapitali themelor i shoqerise eshte ne vleren 2.000.000 (dymilion)leke.

Kerkesa eshte e drejte dhe si e tille duhet pranuar.

## P E R K E T O A R E S Y E

Ne baze te ligjit 7638 dt19.11.1992 dhe ligjit 7667 dt 28.01.1993

## V E N D O S A

Rregjistrimin e Shoqerise"LEZHA-KONSTRUKSION"sh.p.k. si person juridik me administrator Ortakun Zef Gjetja Kapitali themelor i shoqerise eshte ne shumen 2.000.000 (dymilion)leke, me adrese ne Tresh Lezhe objekti i se ciles eshte:

-Ne fushen e tregtimit me shumice e pakice, import eksport te artikujve te ndryshem ushqimore e Industriale. Prodhim e tregtim te materialeve te ndertimit, inerte, blloqe e soleta betoni,tregetim makinerish dhe automjetesh, pjese kembimi per makineri dhe automjete, pike shitje me pakice i karburanteve, gazit te lenget dhe i vajrave lubrifikante, Ndertime civile-Industriale-Turistike-Bujqesore deri ne 5 kate, Ndertim rruge - ura e vepra arti, Ndertim ujesjellesa-kanalizime-Kanale e impiante vaditje, Ndertim Sillosa, kulla, Kulla uji prej B/arme-metalie, punime karpentierie druri, pastrim i siperfaqeve urbane si dhe cdo lloja aktiviteti te lejuar me ligj.

Kjo shoqeri me seli ne Tresh Lezhe do te ushtroje aktivitetin privat per nje periudhe mbi 10 vjet.

Kunder ketij vendimi lejohet ankim.

Tirane 01.03.2005

GJYQTARE
Ariana Coço

**REPUBLIKA E SHQIPERISE**
**GJYKATA E RRETHIT GJYQSOR TIRANE**
**Nr.33086/1**

## VENDIM
## PER KORIGJIMIN E GABIMEVE NE VENDIMIN E RREGJISTRIMIT TE PERSONIT JURIDIK.

Ne Tirane sot me dt 13.12.2005 ume Gjyqtare e Gjykates se Rrethit Gjyqsor Tirane pasi studiova kerkesen dhe dokumentat e kerkuesit Zef Gjetja admnistrator i shoqerise, per korigjimin e gabimeve ne vendimin Nr.33086 , date 01.03.2005 te Gjykates se Shkalles se pare Tiranë per rregjistrimin si person juridik te shoqerise **"LEZHA KONSTRUKSION"** sh.p.k

## KONSTATOVA:

Me vendimin Nr.33086 , date 01.03.2005 te Gjykates se Shkalles se Pare Tiranë eshte rregjistruar si person juridik te shoqeria **"LEZHA KONSTRUKSION"** sh.p.k.

Ne kete vendim si ne pjesen arsyetuese dhe ne pjesen e dispozitivit nuk jane shenuar te dy ortaket por vetem njeri dhe konkretisht vetem Zef Gjetja. Nderkohe ne Aktin e themelimit dhe ne Statutin e kesaj shoqerie del qe ortake jane Zef Gjetja dhe Atmit Gjetja dhe admnistrator eshte Zef Gjetja.

Me te drejte kerkuesi kerkon korigjimin e ketyre gabimeve.

Kerkesa eshte e drejte dhe si e tille duhet pranuar.

## PER KETO ARSYE:

Ne baze te nenit 5, 7 te ligjit Nr.7638 dt 19.11.1992 dhe 7667, dt 28.01.1993

## VENDOSA

Pranimin e kerkeses.

Korigjimin e gabimeve te vendimit Nr.33086 , date 01.03.2005 te Gjykates se Shkalles se Pare Tiranë per rregjistrimin si person juridik te shoqerise **"LEZHA KONSTRUKSION"** duke shenuar se ortake jane z.Zef Gjetja dhe Atmir Gjetja dhe admnistrator eshte z.Zef Gjetja

**GJYQTARE**

Ariana Caco

33086

# AKTI I THEMELIMIT I
# SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
# "LEZHA-KONSTRUKSION " sh.p.k

## FORMIMI

Formohet shoqeria me pergjegjesi te kufizuar e emertuar "LEZHA-KONSTRUKSION" Sh.p.k. e ortakeve themelues Zef Gjetja e Atmir Gjetja sot me daten 25.02.2005

## SELIA

Selia e shoqerise tregtare me pergjegjesi te kufizuar "LEZHA-KONSTRUKSION" sh.p.k. eshte ne Tresh, Lezhe.Ajo do te hape filiale dhe ne rrethe te tjera brenda dhe jashte vendit.

## KOHEZGJATJA

Kohezgjatja e veprimtarise ekonomike te shoqerise eshte mbi 10 vjet me miratim unanim te asamblese se ortakeve mund te nderpritet aktiviteti i shoqerise para afatit.

## OBJEKTI I VEPRIMTARISE

Objekti I veprimtarise ekonomike te shoqerise "LEZHA-KONSTRUKSION "sh.p.k. eshte: -Ne fushen e tregtimit me shumice e pakice, import eksport te artikujve te ndryshem ushqimore e Industriale. Prodhim e tregtim te materialeve te ndertimit, inerte, blloqe e soleta betoni,tregetim makinerish dhe automjetesh, pjese kembimi per makineri dhe automjete, pike shitje me pakice i karburanteve, gazit te lenget dhe i vajrave lubrifikante, Ndertime civile-Industriale-Turistike-Bujqesore deri ne 5 kate, Ndertim rruge - ura e vepra arti, Ndertim ujesjellesa-kanalizime-Kanale e impiante vaditje, Ndertim Sillosa, kulla, Kulla uji prej B/arme-metalie, punime karpentierie druri, pastrim i siperfaqeve urbane si dhe cdo lloja aktiviteti te lejuar me ligj.

## KAPITALI I SHOQERISE

Kapitali themelor i shoqerise eshte ne vleren 2.000.000 (dymilion)Leke i investuar ne raportet : Zef Gjetja ne masen 50% Atmir Gjetja ne masen 50% .

Ne baze te kuotave te pjesemarrjes midis ortake do te ndahet fitimi .

## ORGANET DREJTUESE

Shoqeria tregtare “LEZHA-KONSTRUKSION“sh.p.k. drejtohet nga ortaku Zef Gjetja i cili eshte edhe administratori i shoqerise dhe qe do te perfaqesoje shoqerine ne marredheniet me te tretet.

Asamblea e ortakeve ka te drejte te nderroje administratorin i cili mund te caktohet edhe jashte rrethit te ortakeve

## DISPOZITA TE TJERA

Konfliktet qe mund te lindin ndermjet ortakeve duhet te zgjidhen me mirekuptim ne te kundert kompetente eshte gjykata e rrethit Tirane.

Dispozitat me hollesisht parashikohen ne statutin e shoqerise.

Ortaket pasi lexuan me vemendje Aktin e Themelimit dhe e gjeten konforme kerkimit dhe vullnetit te tyre, me deshiren dhe vullnetin e tyre te lire dhe te plote e firmosen kete akt Themelimi.

**O R T A K E T**

**Zef Gjetja** **Atmir Gjetja**

# S T A T U T

## I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR "LEZHA-KONSTRUKSION" SH.P.K.

Ne baze te ligjit "Per shoqerite tregtare " 7638date 19.11.1992, ligjit 7667 date 28.01.1993 "Per rregjistrin Tregtar e formalitetet qe duhen plotesuar ne te" formohet shoqeria me pergjegjesi te kufizuar "LEZHA-KONSTRUKSION" sh.p.k. e ortakeve themelues Zef Gjetja e Atmir Gjetja.

### DISPOZITA TE PERGJITHSHME
### EMERTIMI I SHOQERISE

**NENI 1**

Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar "LEZHA-KONSTRUKSION"sh.p.k. eshte krijuar ne baze te Aktit te Themelimit dhe ketij Statuti te perpiluar dhe nenshkruar nga ortaket themelues;

Zef Gjetja i biri i Pjetrit i datelindjes 15.02.1970 lindur dhe banues ne Tresh Lezhe.

Atmir Gjetja i biri i Pjetrit i datelindjes 31.05.1984 lindur dhe banues ne Tresh, Lezhe.

**NENI 2**

Emertimi i shoqerise eshte "LEZHA-KONSTRUKSION"sh.p.k.

### SELIA E SHOQERISE

**NENI 3**

Selia e Shoqerise me pergjegjesi te kufizuar "LEZHA-KONSTRUKSION"sh,.p.k. eshte ne Tresh, Lezhe, ajo gezon te drejten per te hapur filiale, dege apo agjensi te tjetra si brenda dhe jashte vendit.

### KOHEZGJATJA

**NENI 4**

Kohezgjatja e veprimtarise ekonomike te shoqerise "LEZHA-KONSTRUKSION" sh.p.k. eshte mbi 10 vjet me te drejte riperteritje, me miratim unanim te asamblese se ortakeve mund te nderpritet aktiviteti i shoqerise para afatit.

### OBJEKTI I VEPRIMTARISE

**NENI 5**

Objekti i veprimtarise ekonomike te shoqerise "LEZHA-KONSTRUKSION" sh.p.k. eshte: -Ne fushen e tregtimit me shumice e pakice, import eksport te artikujve te ndryshem ushqimore e Industriale. Prodhim e tregtim te materialeve te ndertimit, inerte, blloqe e soleta betoni,tregetim makinerish dhe automjetesh, pjese kembimi per makineri dhe automjete, pike shitje me pakice i karburanteve, gazit te lenget dhe i vajrave lubrifikante, Ndertime civile-Industriale-Turistike-Bujqesore deri ne 5 kate, Ndertim rruge - ura e vepra arti, Ndertim ujesjellesa-kanalizime-Kanale e impiante vaditje, Ndertim Sillosa, kulla, Kulla uji prej B/arme-metalie, punime karpentierie druri, pastrim i siperfaqeve urbane si dhe cdo lloja aktiviteti te lejuar me ligj.

**NENI 6**

Shoqeria mund te ndryshoje emertimin, seline, kohezgjatjen dhe objektin e veprimtarise se saj sipas vendimeve te asamblese se ortakeve.

Administratori i Shoqerise me vendim te ortakeve te saj mund te hyje ne marredhenie me shoqeri te tjera te vendit dhe te huaja ne favor te Shoqerise "LEZHA-KONSTRUKSION"sh.p.k..

**KAPITALI I SHOQERISE**

**NENI 7**

Kapitali themelor i shoqerise eshte ne vleren 2.000.000 (dymilion)Leke i investuar ne raportet :

1- Zef Gjetja ne masen 50%

2- Atmir Gjetja ne masen 50% .

Ne baze te kuotave te pjesemarrjes midis ortake do te ndahet fitimi .

**NENI 8**

Ne rast zmadhimi te kapitalit themelor nepermjet shtimit te pjeseve te saj ortaket kane te drejten e rritjes se tyre ne menyre proporcionale.

**NENI 9**

Pjeset e kapitalit themelor jane lirisht te transferueshme ne rruge trashegimie.

Pjeset e kapitalit mund tu transferohen te treteve me miratim te shumices se ortakeve dhe ne kushte jo me te favorshme se ato qe ju jane ofruar me pare ne pjese ortakeve te tjere.

Transferimi i pjeseve te kapitalit themelor duhet te vertetohet me akt noterial.

**NENI 10**

Shoqeria ne emer te vet eshte pronare perdoruese dhe disponuese e pasurive te saj, por gjithmone ne perputhje me qellimin dhe objektin e veprimtarise qe ajo kryen.

Shoqeria mund te shese pasuri ose te shfrytezoje te drejta materiale. Ajo mund te afroje per garanci edhe pasuri te saj per te marre kredi bankare.

## TE DREJTAT DHE DETYRAT E ORTAKVE

### NENI 11

Pjesemarrja ne shoqeri nuk i pengon ortaket te kene pavaresine ligjore per veprimtari te tjera dhe per te drejta te tjera pronesie. Ortaket qe marrin pjese ne shoqeri nuk i nenshtrohen asaj si persona. Ata nuk duhet te pergjigjen per detyrimet e shoqerise qe rrjedhin nga objekti i veprimtarise se saj tej kapitalit themelor ku ata kane marre pjese. Po ashtu edhe shoqeria nuk pergjigjet per detyrimet e ortakeve te saj.

### NENI 12

Ortaket kane keto te drejta kryesore:

1- Te marrin pjese ne administrimin e veprimtarise se shoqerise ne perputhje me aktin e themelimit dhe statutin , vete ose nepermjet perfaqesuesit te tyre.

2- Te marrin pjese ne rezultatet e veprimtarise se shoqerise ne çdo forme dhe sasi qofte, ne perputhje me statutin dhe Aktin e Themelimit.

3- Te marrin pjese ne organet e shoqerise qe jane ose mund te krijohen nepermjet perfaqesuesve te tyre ose vete.

4- Te kerkojne t'iu jepen te gjitha informatat qe kane te bejne ne gjendjen prodhuese dhe tregetare te shoqerise, si dhe te gjithe dokumentat e perpunuara te shoqerise, si bilancet, llogarite ekonomike etj.

5- Te bejne propozime dhe ti paraqesin ato per shqyrtim para organeve te shoqerise.

6- Te emerojne dhe te shkarkojne administratoret, punonjesit, ekspertin kontabel dhe likujdatoret.

7- Te heqin dore nga shoqeria duke u ofruar pjeset e tyre ortakeve te tjere dhe tua ofrojne ato te treteve vetem me rast se asnje nga ortaket e tjere nuk do te ushtroje te drejten e kundershtimit. Heqja dore nga shoqeria nuk e liron ortakun nga detryrimet financiare te marra me pare ndaj shoqerise dhe nuk pezullon detyrimet ndaj ortakeve.

### NENI 13

Ortaket kane keto detyra kryesore:

1- Te depozitojne kuoten e tyre ne perputhje me aktin e themelimit te shoqerise dhe ne kete statut.

2- Te marrin pjese ne administrimin e Shoqerise nepermjet organeve te krijuara prej tyre, vete ose nepermjet perfaqesuesve qe caktojne ato vete.
3- Te kryejne sherbimet e nevojshme per arritjen e objektivave te shoqerise dhe realizimin e funksioneve te saj.
4- Te japin shoqerise informatat e nevojshme qe kane te bejne me ecurine e veprimtarive te saj.

## DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI

### NENI 14

Organ vendimor i shoqerise "LEZHA-KONSTRUKSION"sh.p.k. eshte asamblea e Ortakeve e cila emeron administratorin e shoqerise z.Zef Gjetja i cili ne te njejten kohe ka edhe funksionet e perfaqesuesit te shoqerise me te tretet ne gjithe veprimtarine e saj.

Administrator i shoqerise mund te mos jete ortak i shoqerise, por me miratim te asamblese se ortkeve perfaqeson shoqerine ne marredhenie me te tretet.

Paga e administratorit te shoqerise caktohet me vendim te asamblese se ortakeve.

### NENI 15

Sipas rendesise se vendimeve mbledhja e asamblese se ortakeve mund te jete e zakonshme dhe e jashtezakonshme.

Asamblea e zakonshme vendos me shumice absolute votash per çeshtje te tilla si:

1- Emerimin apo shkarkimin e administratorit.
2- Emerimin apo shkarkimin e ekspertit kontabel te autorizuar.
3- Miratimin e raporteve te administrimit dhe te kontrollit.
4- Miratimin e llogarive vjetore te ndarjes se fitimit.

Asambleja e jashtezakoshme vendos per keto çeshtje si:

1- Ndryshimin e statutit.
2- Zvogelimin e pjeseve te kapitalit, apo zmadhimin e tyre.
3- Transferimin e pjeseve te kapitalit themelor te te treteve.
4- Shnderrimine shoqerise me pergjegjesi te kufizuar ne forma te tjera .
5- Mbylljen e shoqerise.

Vendimet e asamblese se jashtezakoshme miratohen me mbi 51% te kuotes se ortakeve.

### NENI 16

Administratori emerohet dhe shkarkohet me miratim te ortakeve qe zoterojne 51% te kapitalit themelor . Emertimi i tij behet per nje kohezgjatje prej dy vjetesh financiare, me perjashtim te doreheqjes apo shkarkimit te parakohshem. Ne

marredheniet me ortaket administratori ka te gjitha kompetencat per te kryer te gjitha veprimet ne interes te shoqerise dhe ne emrin e saj, nepermjet akteve qe jane ne perputhje me objektin e veprimtarise se shoqerise, me perjashtim te atyre kompetencave qe i njihen shprehimisht ortakut. Administratoret jane pergjegjes individualisht ose solidarisht sipas rastit ndaj shoqerise apo te treteve per shkelje te ligjeve, te statutit, apo per faj te tyre gjate administrimit te shoqerise.

**NENI 17**

Kompetencat e administatorit ne shoqeri jane;

1- Te miratoje planet e llogarive ekonomike pas perpunimit te tyre ne kuadrin e veprimtarise se shoqerise.
2- Te beje propozimet e nevojshme asamblese se ortakeve kur lind nevoja e shtimit te kapitalit themelor te shoqerise.
3- Te miratoje akte normative qe percaktojne marredheniet ne shoqeri, duke perfshire edhe personelin dhe kuadrin.
4- Te percaktoje strukturen e aparatit te shoqerise.
5- Te krijoje organe te tjera te domosdoshme per realizimin e objektivave te shoqerise.
6- Te propozoje ne asamblene e ortakeve per krijimin e njesive, apo strukturave te reja si filiale, dege e agjensi ne qytete te tjera si dhe jashte vendit.
7- Te pergatise propozimin per pushimin e veprimtarise se shoqerise dhe tia paraqese ate asamblese se ortakeve per miratim.
8- Te perzgjedhe ekspertet kontabel dhe anetaret e komisionit te likujdimit dhe te paraqese propozimet per miratim ne asamblene e ortakeve.
9- Te siguroje zbatimin e perpikte te vendimeve te Asamblese.
10-Te percaktoje pagat e te punesuarve ne shoqeri.

**MARREDHENIET E PUNES**

**NENI 18**

Marredheniet e punes ne shoqeri rregullohen ne perputhje me Aktin e themelimit, statutin e kesaj shoqerie dhe ne gjithe legjislacionin shqiptar.

**NENI 19**

Punesimi i punonjesve ne shoqeri do te behet me anen e kontrates se punes, bazuar ne Kodin e Punes dhe aktet e tjera normative qe rregullojne marredheniet e punes.

**NENI 20**

Shoqeria merr persiper sigurimin e te punesuarve ne shoqeri duke derdhur kontributet ne perqindje te caktuara sipas dispozitave ligjore ne fuqi.

## PERFAQESIMI I SHOQERISE

## NENI 21

Perfaqesimi i shoqerise "LEZHA-KONSTRUKSION"sh.p.k. ne marredhenie me te tretet do te behet nga administratori i saj Vladimir Gjeka dhe ne mungese te tij nga perfaqesuesi ligjor me prokure te noterizuar vetem sipas tagreve te caktuara ne prokure.

## KONTROLLI I BRENDSHEM

## NENI 22

Shoqeria tregtare organizon kontrollin e brendshem me nje ekspert kontabel te autorizuar i cili eshte pergjegjes para kesaj shoqerie per demet qe mund ti shkaktoje nga moskryerja ne rregull e detyres se tij.

Emerimi dhe shkarkimi i ekspertit kontabel behet nga asamblea e ortakeve.

## BILANCI DHE TE ARDHUAT

## NENI 23

Veprimtaria ekonomike e financiare e shoqerise mbyllet me 31 dhjetor te çdo viti perveç rasteve e urdherave te veçanta te administratorit te Shoqerise, apo vendimit te asamblese se ortakeve.

Viti i pare financiar fillon diten e rregjistrimit ne organin tatimor.

Ne fund te çdo periudhe ushtrimore nxirret bilanci kontabel me rezultatin ekonomik **HUMBJE FITIME.**

Bilanci kontabel miratohet nga asamblea e ortakeve brenda dates 31 mars te vitit pasardhes dhe pas pagimit te detyrimeve fiskale, pjesa qe mbetet u jepet ne perdorim ortakeve sipas pjeses takuese ne kontributin ne kapitalin themelor.

## SHPERBERJA E SHOQERISE

## NENI 24

Veprimtaria e shoqerise mbaron ne afatin e percaktuar ne kete statut. Veprimtaria e saj mund te mbyllet edhe sipas propozimit te bere nga nje prej ortakeve, kur gjate dy viteve te njepasnjeshme veprimtaria e shoqerise nuk rezulton rentabel ose kur te gjithe ortaket me perjashtim te njerit heqin dore nga shoqeria.

## NENI 25

Kur shoqeria likujdohet asamblea e ortakeve mbledh komisionin e likujdimit, i cili paraqet per miratim bilancin e likujdimit te shoqerise. Me miratimin e ketij bilanci merr fund veprimtaria e shoqerise.

**NENI 26**

Mjetet financiare si dhe çdo pronesi tjeter e fituar si rezultat i veprimtarise se shoqerise kur ajo likujdohet, ndahen ndermjet ortakeve ne perpjestim me kuotat e tyre ne kapitalin themeltar, pasi te jene zbritur dhe kryer pagesat per te gjithe kreditoret e shoqerise.

**DISPOZITA TE FUNDIT**

**NENI 27**

Te gjitha vendimet e shoqerise rregjistrohen ne nje liber te veçante qe mbahet ne seline e shoqerise.

**NENI 28**

Per sa nuk eshte shprehur plotesisht ne kete statut i referohet plotesimeve te bera nga asamblea e ortakeve.

**NENI 29**

Shoqeria do te kete nje vule te saj ne te cilen shkruhet mbishkruhet emertimi i Shoqerise "LEZHA-KONSTRUKSION"sh.p.k. dhe vendodhja e selise qendrore Tresh, Lezhe.

**NENI 30**

Ky statut eshte hartuar sot me daten 25.02.2005 per Shoqerine "LEZHA-KONSTRUKSION" sh.p.k.

**O R T A K E T**

**Zef Gjetja** **Atmir Gjetja**

REPUBLIKA E SHQIPERISE
ZYRA E NOTERISE LEZHE
Nr 615 Rep Nr 193 Kol.

**V E R T E T I M**

~~Sot~~ me daten 25.02.2005 ne zyren e noterise ne Lezhe para meje noterit Vasil Gj. Martini u paraqiten personalisht palet: Zef Gjetja i biri i Pjeter i dt 15.02.1970, me banim ne Tresh, Lezhe i identifikuar me pasaporte me Nr 347488, madhor me zotesi te plote per te vepruar Atmir Gjetja i biri i Pjeter i dt 31.05.1984, me banim ne Tresh, Lezhe, madhor me zotesi te plote per te vepruar, i njohur prej meje Te cilet deklaruan se aktin e themelimit dhe Statutin te mesiperm te perpiluar jashte kesaj zyre e nenshkruajne me vullnetin e tyre te lire dhe te plote para meje noterit dhe une duke e gjetur te bazuar ne ligj e vertetoj.

N O T E R I
Vasil Gj. Martini



33086/1 3, Ariane Caco
NJETOR 13. 2005

**KERKESE**

**KERKUES :** **Zef Gjetja** i biri i Pjetrit i dtl 15.02.1970 lindur e banues ne Tresh Lezhe me cilesine e administratorit te shoqerise **"LEZHA KONSTRUKSION"**

**OBJEKTI :** Korigjim i gabimeve te vendimit Nr.33086 , date 01.03.2005 te Gjykates se Shkalles se pare Tiranë per rregjistrimin si person juridik te shoqerise "LEZHA KONSTRUKSION".

**BAZA LIGJORE :** Neni 5,71 Ligjit nr.7638 dt 19.11.1992 Per shoqerite tregtare.

**DREJTUAR**

**GJYKATES SE RRETHIT GJYQSOR**

**TIRANE**

Ne vendimin Nr.33086 , date 01.03.2005 te Gjykates se Shkalles se Pare Tiranë per rregjistrimin si person juridik te shoqerise "LEZHA KONSTRUKSION" eshte shenuar vetem nje ortak nderkohe qe ne aktin e themelimit dhe ne statut del qarte se jami dy ortake Zef Gjetja dhe Atmir Gjetja dhe admnistrator eshe Zef Gjetja

Ky fakt me ka sjelle probleme per plotesimin e dokumentacioneve per Zyren e Tatimeve dhe çdo problem qe kane lidhje me kete vendim.

Ne kete menyre i drejtohem gjykates per te korigjuar kete gabim, prandaj ju lutem me caktoni nje dite per gjykim ku ne fund te vendoset pranimi i kerkeses sime.

Bashkangjitur dhe dokumentacioni i nevojshem per kete qellim.

Vendimi i gjykates Nr.33086, date 01.03.2005 i Gjykates se Shkallws Se Pare Tirane .(fotokopje)

Akt Themelimi dhe Statut i shoqerise (fotokopje)

**ADMNISTRATORI**
**Zef Gjetja**

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERISE TIRANE
NR. 11420 REP.
NR. KOL.

# VERTETIM

Sot me date 12.12.2005, para meje noterit publik, u paraqit personalisht z. **Zef Gjetja** i biri i Pjetrit i dtl 15.02.1970 lindur e banues ne Tresh Lezhe me cilesine e administratorit te shoqerise **"LEZHA KONSTRUKSION"** me zotesi te plote juridike per te vepruar, per identitetin e te cilit u sigurova, i cili deklaroi se sa me siper e ka redaktuar jashte kesaj zyre me vullnertin e tij te lire e te plote . Une noteri e vertetoj ate sipas ligjit.

**NOTERI PUBLIK**

REPUBLIKA E SHQIPERISE FATMA... NOTER TIRANE

NOTERE
FATMA... SHEHU
TIRANË ALBANIA

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTEREVE SHKODER
ZYRA E NOTERISE LEZHE
Nr 615 Rep Nr 113 Kol.



# *K O N T R A T E   P U N E*

Sot me daten 25.02.2004(dymije e kater) ne zyren e noterise ne Lezhe para meje noterit Vasil Gj. Martini u paraqiten vullnetarisht palet.

**PUNEDHENESI**

1-Shoqeria "LEZHA - KONSTRUKSION"SH.P.K.me qender ne Lezhe perfaqesuar nga administratori i saj Zef Gjetja i biri i Pjetrit i datelindjes 15.02.1970 me banim ne Tresh Lezhe madhor me zotesi te plote per te vepruar, Iidentifikuar me nga njohja personale.

**PUNEMARRESI**

2- Pjeter Lekgjonaj i biri i Ndreut i datelindjes 08.11.1961 me banim ne Lezhe madhore me zotesi te plote per te vepruar, i identifikuare me pasaporte.

Palet bien dakort te lidhin kete kontrate pune me kushtet qe vijojne:

**Neni 1**

Punedhenesi puneson prane vetes me cilesine e Drejtuesit teknik te Shoqerise punemarresin Pjeter Lekgjonaj

Raporti i punes nepermjet personit punedhenes dhe personit te punesuar fillon nga data 01.03.2005 deri me 01.03.2007.

**Neni 2**

Periudha ditore e punes do te jete 8 ore, ajo javore pese dite nga e hena deri te premten.

**Neni 3**

Paga mujore e personit te punesuar do te jete ne vleren 15.000 (pesembedhjetemije)leke ne muaj dhe kjo shume te hollash do te paguhet çdo date 20 te muajit.

**Neni 4**

Pushimi vjetor i te punesuarit do te jete 21 dite kalendarike, data e fillimit dhe mbarimit te kesaj periudhe do te caktohet nga palet me mirekuptim.

**Neni 5**

Vendi i punes do te jete prane Shoqerise "LEZHA-KONSTRUKSION" SH.P.K. ne Lezhe

**DERYRIMET E PALEVE NDAJ NJERA-TJETRES**

**Neni 6**

Punedhenesi zotohet te paguaje te punesuarin ne datat e caktuara ne kete kontrate.

**Neni 7**

Punedhenesi do te derdhe rregullisht sipas kritereve te caktuara me ligj 34.2% vleren e sigurimeve shoqerore ne favor te punemarresit.

**Neni 8**

Punemarresi do perballoje vleren ne leke qe i perket 11.7% te pages reale qe sipas ligjes duhet te paguaje vete.

**Neni 9**

Punedhenesi do ti siguroje punemarresit kushte te favorshme sipas profilit te punes qe do te kryeje.

**Neni 10**

Punemarresi do te kete detyren e Drejtuesit teknik te Shoqerise "LEZHA- KONSTRUKSION" sh.p.k. ne Lezhe.

**Neni 11**

Punemarresi zotohet te kryeje punen me cilesi duke rrespektuar rregullat e punes te caktuara ne rregulloren e punes me punedhensin. Gjithashtu te rimbursoje shoqerine per demet qe i shkakton per fajin e tij dhe te mbaje ne kushte te mira vendin dhe mjetet e punes te dhena ne perdorim.

## RINOVIMI I KONTRATES SE PUNES DHE ZGJIDHJA E MOSMARREVESHEJEVE

**Neni 12**

Kjo kontrate lidhet per nje afat kohor 2 vjeçar ky afat mund te riperseritet automatikisht edhe per n je periudhe te njejte ne qofte se palet nuk kerkojne te nderpresin raportin para skadimit te afatit te caktuar ne nenin 1.

**Neni 13**

Palet ruajne te drejten e zgjidhjes se kontrates per aresye qe parashikohet nga ligji, duke komunikuar kete te drejte me shkrim.

**Neni 14**

Per mosmarrveshjet qe mund te lindin gjate zbatimit te kesaj kontrate, palet do te bejne c'eshte e mundur qe ti zgjidhin me mirekuptim , ne rast se nje mundesi e tille rezulton e pamundur , ato mund ti drejtohen gjykates per zgjidhje dhe kompetente eshte gjykata e rrethit Lezhe.

Kjo kontrate eshte e redaktuar ne tre kopje te njejta te cilat pasi lexohen nga palet dhe gjenden te shkruara sipas vullnetit te tyre te lire, firmosen ne pranine time dhe nga une Noteri dhe duke e gjetur te bazuar ne ligj e vertetoj me te drjeten qe me jep ligji.

**PALET KONTRAKTUESE**

**PUNEDHENESI**
Shoqeria **"LEZHA-KONSTRUKSION"SH.P.K.**
**Perfaqesuar nga Zef Gjetja**

**PUNEMARRESI**
**Ing. Pjeter Lekgjonaj**

**NOTER**
**Vasil Gj. Martini**

**MINISTRIA E RREGULLIMIT TE TERRITORIT DHE TURIZMIT**
**Komisioni i Dhënies së Liçensave Profesionale**

# *LIÇENSE*
## Z.4249



| | |
|---|---|
| **MBIEMRI** | **LEKGJONAJ** |
| **EMRI** | **PJETER** |
| **ATESIA** | **NDRE** |
| **DATELINDJA** | **08.11.1961,LEZHE** |
| **VENDBANIMI** | **LEZHE** |
| **DIPLLOMUAR, ME** | **1996** |
| **TITULLI** | **Ing. Ndertimi Civ-Industriale** |
| **Regjistruar ne Regjistrin themeltar qe nga data** | **28.06.2004** |

**NE ZBATIM**

| | | | |
|---|---|---|---|
| **Kat.** | **1** | | Germime dheu me punime eventuale urature dhe beton-arrme, prishje dhe punime ne toke te germuar. |
| **Kat.** | **2** | **a** | Prodhim materiale inerte - gure . |
| | | **c** | Prodhim elemente betoni e betonarme te zakonshme – paranderur – gure dekorativ. |
| **Kat.** | **3** | **a** | Ndertime civile – industriale – turistike - bujqesore, deri ne 5 kate |
| **Kat.** | **4** | **a** | Ndertim rruge kategoria IV dhe V. |
| **Kat.** | **6** | **a** | Ndertim ura dhe vepra arti deri 10 m |
| **Kat.** | **8** | **a** | Ndertim ujesjelles-kanalizime-kanale e impiante vaditje |
| **Kat.** | **9** | **a** | Sillosa, kulla, kulla uji etj prej b/arme - metalike. |
| **Kat.** | **11** | **a** | Punime karpenterie druri |
| **Kat.** | **14** | **b** | Pastrim I siperfaqes urbane. |

**KRYETARI I KOMISIONIT**

**Arben DEMETI**

Republika e Shqipërisë
Noteria LEZHE
Nr 61 V Rep 24/02/2008
Vërtetohet njësia me Origjinalin
NOTER VASIL MARTINI

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTEREVE SHKODER
ZYRA E NOTERISE LEZHE
Nr 627 Rep Nr 196 Kol.

# V E R T E T I M

Sot me daten 25.02.2005 ne zyren e noterise ne Lezhe une Noter Vasil Gj Martini vertetoj se kane depozituar shumen prej 2.000.000(dymilione) leke ortaket Themelues te Shoqerise "LEZHA-KONSTRUKSION"sh.p.k. Zef Gjetja e Atmir Gjetja.

Kjo shume eshte kapitali themelor i Shoqerise "LEZHA-KONSTRUKSION"sh.p.k. i depozituar prane zyres time per te vertetuar shumen e Kapitalit themelor konforme ligjit 7829 date 01.06.1994 "Per Noterine" neni 62 paragrafi I dyte.

Leshoj kete vertetim (deftese) per te vertetuar shumen e kapitalit themelor te Shoqerise me Pergjegjesi te Kufizuar "LEZHA-KONSTRUKSION"sh.p.k.me Seli Tresh te rrethit Lezhe, te derdhur nga Ortaket Zef Gjetja e Atmri Gjetja.

N O T E R
Vasil Gj Martini

33086

3 A Cara 28 02 2005

# K E R K E S E

KERKUES - Zef Gjetja i biri i Pjetrit i dt 1970, me banim ne Tresh Lezhe.
- Atmir Gjetja i biri i Pjetrit i dt. 1984, me banim ne Tresh Lezhe

ME OBJEKT - Pranimin e kerkeses per rregjistrimin ne Rregjistrin Tregetar si person juridik te Shoqerise "LEZHA-KONSTRUKSION" sh.p.k.
Me seli ne Tresh Lezhe Me Administrator Ortakun Zef Gjetja

AZA LIGJORE -Neni 5 i ligjit 7512 dt 10.08.1991,si dhe ligji7638 dt 19.11. 1992"Per Shoqerite tregtare" Ligji 7667 i dt 28.1.1993 "Per rregjistrimin ne Rregjistrin Tregetar."

**PARA GJYKATES SE SHKALLES SE PARE**
**T I R A N E**

**z. Kryetar .**

Ne te tre kerkuesit Zef Gjetja e Atmir Gjetja me zotesi te plote juridike per te epruar mbi bazen ligjore te mesiperme nga kjo Gjykate kerkojme:

Pranimin e kesaj kerkese dhe rregjistrimin ne Rregjistrin tregetar te Shoqerise EZHA-KONSTRUKSION"sh.p.k. me administrator Ortakun Zef Gjetja me aktivitet tregtar me jekt si me poshte: -Ne fushen e tregtimit me shumice e pakice, import eksport te artikujve te ryshem ushqimore e Industriale. Prodhim e tregtim te materialeve te ndertimit, inerte, blloqe e leta betoni,tregetim makinerish dhe automjetesh, pjese kembimi per makineri dhe automjete, xe shitje me pakice i karburanteve, gazit te lenget dhe i vajrave lubrifikante, Ndertime civile-dustriale-Turistike-Bujqesore deri ne 5 kate, Ndertim rruge - ura e vepra arti, Ndertim sjellesa-kanalizime-Kanale e impiante vaditje, Ndertim Sillosa, kulla, Kullauji prej B/arme-talie, punime karpentierie druri, pastrim i siperfaqeve urbane si dhe cdo lloj aktiviteti te lejuar ligj.

Adresa e kesaj shoqerie eshte ne Tresh Lezhe
Kjo Shoqeri do te vazhdoje aktivitetin per nje kohe mbi 10 vjet.
Kapitali themelor i shoqerise eshte ne shumen 2.000.000 (dymilione)leke.
Administrator i kesaj Shoqerie do te jete Zef Gjetja.

**K E R K U E S I T**

| | |
|---|---|
| **Zef Gjetja** | **Atmir Gjetja** |